



CleanScore është një projekt i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF). Ky projekt përbëhet nga dy komponentë të rëndësishëm për arsimin e lartë në Shqipëri: vlerësimin e automatizuar të



testimeve dhe përkthimin e teksteve akademike ndërkombëtare, duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e Cilësisë së Arsimit të Lartë.

CleanScore implementohet nga AADF dhe me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë në:
Universitetin e Tiranës (UT)
Universiteti i Durrësit (UAMD)
Universiteti European i Tiranës (UET)
Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)

Vlerësimi i automatizuar i testimeve

Funksionimi i procesit të korigjimit ndiqet nga tre faza kryesore: dizenjimi, skanimit dhe korigjimi. Programi i korigjimit nxjerr pikët për çdo student, mesataren e klasës, shpërndarjen e notave si dhe shumë raporte të tjera statistikore të cilat ndihmojnë pedagogun për përmirësimin e testimeve me vlerësime uniforme, të sakta dhe transparente.

Tekstet akademike

Përkthimi në shqip i teksteve akademike ndërkombëtare ndikon në përmirësimin e cilësisë së teksteve akademike në Shqipëri duke i siguruar studentëve një njohuri sa më koherente. Aktualisht janë blerë të drejtat e përkthimit për 4 libra: Sipërmarrja, Financa Personale, Kontabiliteti Financiar, Biznesi Ndërkombëtar. Libri Sipërmarrja është botuar dhe është në dispozicion të studentëve që prej shtatorit të vitit 2018. 3 librat e tjerë do të jenë në dispozicion të studentëve në vitin akademik 2019.

